

E nderuar Ministre,
I nderuari z. Berisha,
Të nderuar të pranishëm,

Është kënaqësi e veçantë të jem pjesë e kësaj ceremonie që shënon përvjetorin e shtatë të themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, e gjithashtu edhe të lancimit të dy dritareve të reja garantuese, për Gratë në Biznes dhe Start Up.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, me përkrahjen edhe të miqve dhe partnerëve ndërkombëtar, brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore ka arritur të shndërrohet në një institucion shumë të rëndësishëm, duke luajtur një rol të veçantë në rritjen dhe lehtësimin e financimit për ekonominë e vendit.

Kreditimi bankar vazhdon të jetë një burim shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit të sektorit privat në Kosovë. Vlera e kredive të sektorit bankar deri në muajin shkurt 2023 ka arritur në 4.38 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 15.1%.

Megjithëse ekziston një trend i kënaqshëm i rritjes së kreditimit në vend, shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë duhet të rritet edhe më tej, dhe se në raport me madhësinë e ekonomisë, ekziston hapësirë e mëtejme për zgjerim të aktivitetit të kredidhënies, e sidomos për përfshirjen e grave në aktivitete ekonomike.

Një rol tepër të rëndësishëm në plotësimin e kësaj hapësire e ka pikërisht Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, i cili përmes mekanizmit të tij garantues do të mundësojë rritjen e kreditimit dhe lehtësimin e kushteve të qasjes në kredi.

Më lejoni t'i ndaj disa të dhëna nga sektori bankar me juve; numri i llogarive të bizneseve me pronare gra në sektorin bankar është 21,247 krahasuar me 104,461 me pronarë burra, apo 17 përqind të gjithsej llogarive, vlera e depozitave të bizneseve me pronare gra është 112 milionë euro apo 7 përqind e gjithsej depozitave të bizneseve nga 1.7 miliardë.

Numri i kredive të bizneseve me pronare gra është 8,185 apo 25 përqind e numrit të kredive të bizneseve, krahasuar me numrin e kredive prej 24,546 apo 74 përqind të bizneseve me pronarë burra. Ndërkohë që vlera e kredive të bizneseve me pronare gra është 643 milionë euro apo 29 përqind të totalit të kredive të bizneseve prej 2,2 miliardë.

Andaj, Dritarja e re garantuese për gratë në biznes përveç se është lajm i mirë për bizneset e reja dhe ekonominë e vendit në përgjithësi, është e një rëndësie të veçantë që përveç fuqizimit ekonomik të grave, do të ndikojë edhe në përfshirjen e tyre në ekonominë e vendit dhe në fusha tjera të jetës.

BQK-ja e sheh dritaren e re garantuese për gratë në biznes si një mundësi të mirë për promovimin e barazisë gjinore dhe beson se barazia e mundësive ekonomike për gratë dhe burrat është një element kyç i një ekonomie tregu moderne, mirëfunktionale dhe është thelbësore për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Rol të rëndësishëm në shkallën e ndërmjetësimit financiar do të luajë edhe Dritarja për start up, përmes të cilës do të përkrahen ndërmarrës të rinj, që kanë qëllim nisjen e realizimit të një modeli biznesi, produkti apo inovacioni, me potencial të shpejtë të rritjes dhe zgjerimit. Duke pas parasysh ngurrimin e sektorit bankar për financimin e bizneseve start up për shkak të rrezikut të lartë që shoqërojnë këto biznese, dritarja e re garantuese për start up do të ndikojë në rritjen e përfshirjes financiare, e me këtë edhe të rritjes dhe zgjerimit të aktivitetit të tyre.

Këto dy dritare garantuese për gratë në biznes dhe start up do të ndihmojnë në rritjen dhe zhvillimin e bizneseve, duke kontribuar në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit.

Për fund , dëshirojmë t'i përgëzojmë bankat të cilat janë pjesë e këtyre dritareve dhe t'i inkurajojmë edhe bankat tjera të përfshihen në projekte të tilla.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon të mbështesë dhe të shtyjë sektorin financiar në rritjen e mbështetjes ndaj ekonomisë së vendit.

Ju faleminderit!